



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 889/4 Prot

Tiranë, më 30.12.2020

**V E N D I M**

Nr.220, datë 30.12.2020

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së ankesës së nëpunësit \*\*\*\*\*, me objekt ulje të paligjshme në detyrë nga pozicioni “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në pozicionin “Përgjegjës i zyrës së taksave dhe tarifave familjare”, dhe me pas largimin nga ky pozicion pune, në Bashkinë Rrogozhinë.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e ankesës së nëpunësit \*\*\*\*\* për ulje të paligjshme në detyrë dhe më pas, largimin nga shërbimi civil,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet shkresës me nr. 889 prot., datë 20.11.2020, është protokolluar ankesa e nëpunësit \*\*\*\*\* , përmes së cilës ngrihen disa pretendime, për ulje të paligjshme në detyrë nga pozicioni “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në pozicionin “Përgjegjës i zyrës së taksave dhe tarifave familjare” pranë Bashkisë Rrogozhinë dhe me pas, largimin nga ky pozicion pune, në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të përmendura në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Nga përmbajtja e ankesës rezulton se, shkak për mosmarrëveshjen që përbën objektin e hetimit administrativ, është bërë fillimisht, Urdhri nr. 93, datë 15.05.2020, (nr. 2412 prot., datë 15.05.2020), i Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, nëpërmjet të cilit nëpunësi \*\*\*\*\* , është ulur në detyrë nga pozicioni “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në

pozicionin “Përgjegjës i zyrës së taksave dhe tarifave familjare”, pranë kësaj Bashkie, me motivacionin, për shkak të mosarritjes së objektivave në punë e më pas, Urdhri nr. 153, datë 15.06.2020, (nr. 2840 prot., datë 15.06.2020), me të cilin është urdhëruar lagimi i nëpunësit \*\*\*\*\*, nga pozicioni “Përgjegjës i zyrës së taksave dhe tarifave familjare”, duke urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për këtë punonjës në datë 28.06.2020.

Nga ana e kërkuesit është ngritur pretendimi se, të dy urdhrat e mësipërm, janë akte të nxjerra në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në bazë e për zbatimin e tij dhe është kërkuar ndërhyrja e Komisionerit për konstatimin e shkeljeve ligjore të ndodhura dhe rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, në zbatim të kompetencave të ngarkuara nga ligji.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e e mësipërme, nëpërmjet shkresës nr. 889/1 prot., datë 03.12.2020, me objekt: “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e ankesës së nëpunësit \*\*\*\*\*”, janë kërkuar nga institucioni Bashkia Rrogzhinë, sqarime dhe dokumentacioni që materializon veprimet e kryera nga ana e institucionit, në këtë rast.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Rrogzhinë, me shkresën nr. 6385/1 prot., datë 11.12.2020, me objekt: “Dërgim dokumentacioni”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 889/2 prot., datë 14.12.2020, ka paraqitur sqarimet si dhe dokumentacionin e kërkuar për rastin në fjalë. Gjithashtu, me e-mailin e datës 24.12.2020, nëpunësja e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionin Bashkia Rrogzhinë, në përgjigje të kërkesës për plotësimin e dokumentacionit të dërguar, përcolli edhe gjithë procedurën e konkurrimit për pozicionin e punës “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse” në këtë bashki, ku fitues ka rezultuar kandidati \*\*\*\*\*.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të konkurrimit, rezulton se Bashkia Rrogzhinë me shkresën e datës 22.11.2019, me objekt: “Kërkesë për publikim vendesh të lira”, dërguar Shërbimit Kombëtarë të Punësimit, ka bërë shpalljen e procedurave të konkurrimit për lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil, për pozicionet “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse” dhe “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”.

Pas zhvillimit të procedurës së konkurrimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, me Vendimin nr. 5655/3 prot., datë 30.12.2019, “Për rezultatin e procedurës së pranimit në shërbimin civil”, të Komitetit të Përhershëm të Pranimit, kandidati i vetëm i kualifikuar me më shumë se 70 pikë, për pozicionin “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në Bashkinë Rrogzhinë, ishte konkurrenti \*\*\*\*\*. Ky fakt është konfirmuar edhe me shkresën nr. 5697 prot., datë 31.12.2019, “Kërkesë për publikim për njoftim fituesi”, të Bashkisë Rrogzhinë, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për shpalljen e konkurrentit \*\*\*\*\*; fitues për pozicionin “Drejtor i Shërbimeve

*Mbështetëse*” në Bashkinë Rrogozhinë dhe me shkresën nr. 5697/1 prot., datë 31.12.2019, të njësisë përgjegjëse me të cilën është njoftuar edhe i interesuari.

Në përfundim të procedurës së mësipërme dhe në mbështetje të akteve të sipërcituara, Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë me aktin nr. 70 prot., datë 06.01.2020, *“Akti i emërimit të statusit të punësimit, nëpunës civil periudhë prove”*, ka emëruar kandidatin \*\*\*\*\* në pozicionin *“Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”*, në periudhë prove, kategoria II b, në këtë bashki.

Pas disa muajsh, në vijim të kryerjes së detyrës në këtë pozicion, Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, përmes Urdhrit nr. 93, datë 15.05.2020, (nr. 2412 prot., datë 15.05.2020), ka urdhëruar që nëpunësi \*\*\*\*\*, të kalojë nga pozicioni *“Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”*, në pozicionin *“Përgjegjës i zyrës së taksave dhe tarifave familjare”*, me motivacionin, *“për shkak të mosarritjes së objektivave në punë”*.

Një muaj më pas, drejtuesi i bashkisë me Urdhrit nr. 153, datë 15.06.2020, (nr. 2840 prot., datë 15.06.2020), ka urdhëruar largimin e nëpunësit \*\*\*\*\*, nga pozicioni *“Përgjegjës i zyrës së taksave dhe tarifave familjare”*, duke urdhëruar njëkohësisht, ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, në datën 28.06.2020.

Duke analizuar zhvillimet e mësipërme, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ të këtij rasti, konstatohet që akti nr. 70 prot., datë 06.01.2020, i nxjerrë në përfundim të procedurës së konkurrimit, për emërimin e \*\*\*\*\* në pozicionin *“Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”*, si nëpunës civil në periudhë prove, është një akt administrativ i ligjshëm, por që përmban një element të kundërligjshëm, pasi nëpunësi në fjalë, bazuar në pikën 40, të kreut III, *“Ngritja në Detyrë”*, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar, nuk ishte e nevojshme ti nënshtrohej periudhës së provës.

Megjithatë, ky zbatim i gabuar i ligjit nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, nuk prek vlefshmërinë e procesit të rekrutimit dhe emërimit, të nëpunësit \*\*\*\*\*, prandaj ai e ka fituar statusin e nëpunësit civil edhe pse është konsideruar pa të drejtë nëpunës në periudhë prove.

Sa i përket Urdhrit nr. 93, datë 15.05.2020, me atë të së cilit punonjësi \*\*\*\*\*, është ulur në detyrë nga pozicioni *“Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”*, në pozicionin *“Përgjegjës i zyrës së taksave dhe tarifave familjare”*, pranë Bashkisë Rrogozhinë, me motivacionin *“për shkak të mosarritjes së objektivave në punë”*, si dhe Urdhrit nr. 153, datë 15.06.2020, për largimin e këtij nëpunësi nga pozicioni *“Përgjegjës i zyrës së taksave dhe tarifave familjare”*, janë dy akte të nxjerra në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil. Përcaktimi i motivacionit të nxjerrjes së aktit *“mosarritje e objektivave në*

*punë*” të jep të kuptohet se këtu pretendohet të jemi para rastit të *“mospërmshjes së detyrave”*, që parashikohet si shkelje e rëndë e disiplinës në punë, nga pika 3, gërma a) e nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar.

Nëse do pranohet se jemi para një rasti në të cilin, nëpunësi në fjalë ka kryer mospërmshje të detyrave apo mospërmshje të rëndë të detyrave, lind detyrimi i eprorit direkt (në këtë rast, Sekretarit të Përgjithshëm ose në mungesë të tij, Kryetarit të Bashkisë) të bëjë evidentimin, dokumentimin dhe vlerësimin e shkeljeve të kryera dhe nëse arrin në përfundimin se kemi të bëjmë me thyerje disiplinore të cilat mund të ndëshkohen me masat disiplinore të parashikuara nga pikat “b”, “c” dhe “ç”, të nenit 58, të ligjit në fjalë, sipas pikës 2, të nenit 59, të tij, duhet ta dërgojë çështjen për shqyrtim në Komisionin e Disiplinës së institucionit.

Mosrespektimi i procedurës si më sipër, bën që aktet nr. 93, datë 15.05.2020, dhe nr.153, datë 15.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, bazuar në pikën “a” geramat i) dhe ii), të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si akte që vijnë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me legjislacionin në fuqi, lidhur me kompetencën e organit publik dhe procedurën e nxjerrjes së tij, të jenë akte absolutisht të pavlefshëm. Si të tillë këto akte, në vështrim të pikës 1, të nenit 110, të ligjit të sipërpërmendur, nuk mund të sjellin asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse janë konstatuar ose jo si të tillë.

Në përfundim, nga gjithë sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në konkluzionin se, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, organi publik i cili ka nxjerrë aktet e mësipërme, bazuar në nenin 111 dhe 113/1, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”*, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të tyre dhe ti anulojë ato, duke urdhëruar kthimin e nëpunësit \*\*\*\*\*, në punën e mëparshme dhe vetëm pas kësaj, nëse vlerëson që ky nëpunës duhet të mbajë përgjegjësi për shkeljet e kryera, duhet të urdhërojë përsëritjen e ecurisë disiplinore, duke respektuar gjithë rregullat e legjislacionit të shërbimit civil dhe të procedurës administrative, siç u përmend në pjesën e sipërme të këtij relacioni.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në nenet 108, 110, 111 dhe nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në mbështetje të neni 34, pika 1, e Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të Urdhrit nr. 93, datë 15.05.2020, (nr.2412 prot., datë 15.05.2020) dhe Urdhrit nr. 153, datë 15.06.2020, (2840 prot., datë 15.06.2020) dhe ti anullojë ato, me një akt të ri me shkrim.
2. Të urdhërohet kthimi i nëpunësit \*\*\*\*\* në pozicionin e punës, ku ai ka emërimin e rregullt, “*Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse*”, pranë Bashkisë Rrogozhinë dhe vetëm nëse janë faktet dhe dokumentacioni i duhur për mosplotësimin e detyrave nga ana e tij, çështja të dërgohet për shqyrtim në Komisionin e Disiplinës, të kësaj bashkie.
3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **15 ditë**, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Bashkia Rrogozhinë dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**